



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Kuvendi i Komunës së Deçanit  
01 Nr. IX  
Deçan, dt. 13.09.2024

Bazuar në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenin 51 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, bën këtë:


## FTESË

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen IX-të të rregullt të **KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA** për vitin 2024  
Mbledhja do të mbahet me **dt. 24.09.2024, e Martë, në ora 10:00**, në Sallën e Konferencave (në katin e tretë të Komunës)

Për mbledhje propozoj këtë:

## REND PUNE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Buxhetit për vitet 2025-2027;
3. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës(materialin e kini nga mbledhja e kaluar);
4. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Komitetit të Komuniteteve(materialin e kini nga mbledhja kaluar);
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;
6. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një vit;
7. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027;
8. Njoftim i Drejtorisë për Arsim për përgatitjen e vitit shkollor 2024/2025;
9. Shqyrtimi i kërkesave;
10. Të ndryshme.



Kryesuesi i KPF-së  
**Hajdar SUTAJ**



Komiteti për Politikë dhe Financa  
01.Nr.VIII  
Deçan,dt.30.08.2024

### PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VIII-të të rregullt të KPF-së , me dt.30.08.2024.  
Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së ( mungon Hyri Dobrunaj).  
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.  
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i kërkesave;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e VIII-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 6 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje ( mungon Hyri Dobrunaj), pastaj e prezantoi rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Shqyrtimi i kërkesave.

1.kërkesa e Komitetit të Komuniteteve për ndërtimin e një kanali në Lagjen Pemishte, në gjatësi rreth 250m.

Kryesuesi- e prezantoi kërkesën e Komitetit të Komuniteteve për ndërtimin e një kanali me gjatësi rreth 250m, në Lagjen Pemishte për sanimin e ujit rrjedhës i cili vie nga Suka e Baballoqit sa herë që ka të reshura atmosferike dhe e dëmton rrugën e asfaltuar, në vazhdim e hapi debatin rreth kësaj kërkesë.

Florim Mataj-jemi për mi gjete një mundësi, por nuk kemi informata të mjaftueshme me kërkesën që na është drejtuar, prandaj propozoj që kërkesa të drejtohet te Drejtoria për Shërbime Publike.

Vatan Istrefaj- nuk jemi kundër por kërkesa si ka ardhë është e mangët, pa ndonjë paralogari dhe nuk dimë sa kushton, kjo kërkesë nuk është dashtë të adresohet në KPF.

Kryesuesi- t'i rekomandojmë drejtorisë për Shërbime Publike për shqyrtim dhe marrje të vendimit për këtë kërkesë.

KPF njëzëri kërkesën e drejtojnë për shqyrtim në Drejtorinë për Shërbime Publike.

2.Kërkesa e Komisionit për emërim të rrugëve dhe ndarja e mjeteve financiare për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit.

Kryesuesi- e prezantoi kërkesën pastaj e hapi debatin rreth saj.

Vatan Istrefaj- nuk mendoj se është rruga e drejtë me ardhë kjo kërkesë në KPF, nuk jemi kundër që mu pagu ky komision, por jo me vendim të KPF.

Faton Selmanaj- e vlerësoj shumë punën e bërë nga Komisioni për emërim të rrugëve por nuk e di arsyen pse me ardhë kjo kërkesë në KPF.

Yllarta Thaqi- si komision nuk jemi pagu asnjëherë ma shumë se për 6 mbledhje.

Florim Mataj- edhe pse ka ardhë në KPF nuk është e kundërligjshme dhe sa për ne jemi okej.

Faton Selmanaj- nuk e kam të çartë pse me ardhë kjo kërkesë në KPF, prandaj për këtë arsye unë do të abstenoj.

Kryesuesi- e qiti në votim , anëtarët e KPF-së e miratojnë kërkesën e komisionit për emërim të rrugëve, për pagesën e mëditjeve të komisionit, në shumën prej 4650€, vendimi merret me shumicë votash, 5 votuan për, 1 abstenim (Faton Selmanaj).

3.Kërkesa Alban Berishës nga fshati Pozharë, për mbështetje financiare në shumën prej 5000 € për ndërtimin e kulmit të shtëpisë.

Kryesuesi- e ka prezentu kërkesën, pastaj e ka hapë debatin rreth saj.

Vatan Istrefaj- unë e kam lexu kërkesën, është e arsyeshme dhe jam pro.

Yllarta Thaqi- jemi për miratimin e kësaj kërkesë, vetëm kërkojmë që të zbatohet.

Njzëri miratohet kërkesa e Alban Berishës nga fshati Pozharë për ndërtimin e kulmit të shtëpisë në shumën prej 5000 euro.

III.Të ndryshme.

Nuk ka.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni

Kryesuesi i KPF-së  
Hajdar SUTAJ